FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 89

Tiranë – E hënë, 27 prill 2026

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 288, datë 24.4.2026	Për disa ndryshime në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", të ndryshuar.....	8183
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 289, datë 24.4.2026	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 534, datë 22.9.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Ndërtim rruga Porto-Romano–Durrës, loti 3'", të ndryshuar.....	8183
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 290, datë 24.4.2026	Për disa ndryshime në vendimin nr. 875, datë 11.11.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti 'Ndërtimi i nënstacionit 400/110/20 kV, Tirana 3'".....	8184
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 291, datë 24.4.2026	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikimi urban në lagjen "5 Shtatori", Çorovodë, blloku nr. 1 (faza e parë)", Bashkia Skrapar.....	8185
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 292, datë 24.4.2026	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Sistemim, asfaltim, rruga 'Pjetrushi', pranë varrezave të qytetit, Grudë e Re", Bashkia Shkodër.....	8186
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 293, datë 24.4.2026	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Sistemim-asfaltim i rrugëve 'Xhejms Belushi', 'Dhori Koti' dhe rrugëve lidhëse", Bashkia Korçë.....	8188
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 294, datë 24.4.2026	Për miratimin e koeficientit të indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit 2024, për llogaritjen e pensioneve.....	8190

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 295, datë 24.4.2026	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 769, datë 13.12.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për transferimin te Korporata e Investimeve Shqiptare të pronave shtetërore për realizimin e projektit të investimit 'Rijetëzimi i stadiumit 'Selman Stërmasi', Tiranë"'.....	8191
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 297, datë 24.4.2026	Për shpalljen e disa zonave me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore në Bashkinë Selenicë.....	8192
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 298, datë 24.4.2026	Për shpalljen e disa zonave me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore në Bashkinë Dropull.....	8245
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 299, datë 24.4.2026	Për shpalljen e disa zonave me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore në Bashkinë Kurbin.....	8255
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 300, datë 24.4.2026	Për shpalljen e disa zonave me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore në Bashkinë Kamzë.....	8261
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 301, datë 24.4.2026	Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit për financimin e projekteve të bashkive nga programi "Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes"	8268
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 24.4.2026	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2026, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, për përballimin e shpenzimeve të organizimit të aktivitetit kulturor-turistik, që do të zhvillohet në Tiranë, në datën 9 maj 2026, në kuadër të Ditës së Evropës.....	8269

VENDIM
Nr. 288, datë 24.4.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINAN CUES TË TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, e 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit "Lista e OKB-së", që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Në listën e shkronjës "A", të titulluar "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët", ndryshohen të dhënat për 4 (katër) individë të renditur në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për individët e shpallur anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

NDRYSHIMI NË LISTËN E INDIVIDËVE TË SHPALLUR ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME TALIBA-NËT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT
("LISTA E OKB-së")

A. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME TALIBA-NËT

a) Ndryshim në "Listën e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët".

1. MOHAMMAD: HASSAN: AKHUND
2. ABDUL GHANI: BARADAR: ABDUL AHMAD TURK
3. AMIR KHAN: MOTAQI
4. GUL: AGHA: ISHAKZAI

Shënim. Gjenealitetet e tjera për personin, emri i të cilit është radhitur më sipër, mbahen në Agjencinë e Inteligjencës Financiare.

VENDIM
Nr. 289, datë 24.4.2026

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.534, DATË 22.9.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT 'NDËRTIM RRUGA PORTO-ROMANO–DURRËS, LOTI 3'", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 534, datë 22.9.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikat 3 dhe 4, vlera "... 30 349 958 (tridhjetë milionë e treqind e dyzet e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë ..." zëvendësohet me "... 30 646 898 (tridhjetë milionë e gjashtëqind e dyzet e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë ...";

b) Në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

i. Pas numrit rendor 71 shtohet numri rendor 72, sipas të dhënave të tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

ii. Shuma totale 30 349 958 zëvendësohet me shumën totale 30 646 898.

2. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës–Kavajë–Krujë, dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Nr.	PRONARI			Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Sip. totale	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe shpronësimi	Çmimi lekë/(m²)	Vlera (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri								
72	Rrahim	Hamit	Bardhoci	8517	38/27	5650	are	707	420	296,940	Konfirmuar nga ASHK-ja

VENDIM
Nr. 290, datë 24.4.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 875, DATË 11.11.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI 'NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 400/110/20 kV, TIRANA 3'"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 875, datë 11.11.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Ndërtimi i nënstacionit 400/110/20 kV, Tirana 3"", bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikat 3 dhe 4, vlera "... 18 711 640 (tetëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet) lekësh ..." zëvendësohet me "... 55 975 672 (pesëdhjetë e pesë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy) lekësh ...";

b) Tabela, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pronarët e pasurive, që korrespondojnë me numrat rendorë 7, 10, 11 dhe 13 të tabelës, bashkëlidhur vendimit nr. 875, datë 11.11.2020, të Këshillit të Ministrave, që janë likuiduar sipas vlerës së përcaktuar para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, vetëm për diferencën e vlerës së shtuar të kompensimit, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga buxheti i Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 400/110/20 kV, TIRANA 3"

Nr. rendor	Pronësia	Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)				Kompensimi sipas standardit ndërkombëtar (vlera në lekë)			Shënime
	Emër Mbiemër	Lloji i pasurisë	ZK	Nr. pasurie	Sip. e pronës (m²)	Sip. që shpronësohet (m²)	Çmimi i tokës (lekë/m²) llogaritur sipas raportvlerësimit të përgatitur nga ekspertët vlerësues	Vlera e kompensimit sipas standardit ndërkombëtar (në lekë)	
1	Qemal Metoja	Arë	2947	371/5	9,200	9,200	1,406	12,935,200	
2	Artur Xhezmi Sinanaj Ferdinand Xhezmi Sinoma	Arë	2947	371/6	9,000	9,000	1,406	12,654,000	
3	Myrteza Gjashta	Arë	2947	371/11	8,000	1,700	1,406	2,390,200	
4	Mustafa Mahmut Kupi	Arë	2947	371/12	3,450	3,450	1,406	4,850,700	
5	Aqif Maliq Sina, Shaban Maliq Sina	Arë	2947	371/13	4,039	4,039	1,406	5,678,834	
6	Aqif Maliq Sina, Shaban Maliq Sina	Arë	2947	371/14	500	500	1,406	703,000	
7	Valbona Lalaj	Arë	2947	371/15	1,500	1,500	1,406	2,109,000	
8	Muhamet Abdulla Zaja	Arë	2947	371/16	5,000	5,000	1,406	7,030,000	
9	Aqif Maliq Sina, Shaban Maliq Sina	Arë	2947	371/17	261	261	1,406	366,966	
10	Jakup Kupi	Arë	2947	371/18	2,000	2,000	1,406	2,812,000	
11	Mustafa Isak Doda	Arë	2947	371/19	2,000	2,000	1,406	2,812,000	
12	Fatmir Maliq Çejku, Ylber Maliq Çajku, Nexhmije Maliq Gjana, Hatije Maliq Domi, Meriman Maliq Çejku, Fitore Maliq Çela, Luan Maliq Çajku, Abaz Maliq Çejku	Arë	2947	5/1/6	14,950	457	1,406	642,542	
13	Bashkim Isuf Kupi	Arë	2947	5/1/30	220	220	1,406	309,320	
14	Isuf Jakup Kupi	Arë	2947	5/1/8	1,000	41	1,406	57,646	
15	Mustafa Mahmut Kupi	Arë	2947	5/1/9	9,950	444	1,406	624,264	
Sipërfaqe totale shpronësimi (m²)						**39,812**			
Nënstacioni 400/110/20 kV, Tirana 3 – shuma e kompensimit (lekë)								**55,975,672**	

VENDIM
Nr. 291, datë 24.4.2026

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKUALIFIKIMI URBAN NË LAGJEN "5 SHTATORI", ÇOROVODË, BLLOKU NR.1 (FAZA E PARË)", BASHKIA SKRAPAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikimi urban në lagjen "5 Shtatori", Çorovodë, blloku nr.1 (faza e parë)", Bashkia Skrapar.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Skrapar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit "ndërtesë" dhe "garazh", me një vlerë të përgjithshme prej 893 955 (tetëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 893 955 (tetëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë) lekësh përballohet nga buxheti i Bashkisë Skrapar.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Skrapar.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në "Fletoren zyrtare" dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi

të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Skrapar.

8. Bashkia Skrapar kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Skrapar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Skrapar për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe të regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Skrapar për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Skrapar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË PRONË PRIVATE, E TË CILËVE SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKUALIFIKIM URBAN NË LAGJEN 5 SHTATORI ÇOROVODË, BLLOKU NR 1 (FAZA E PARË)"

Nr. rendor	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)												Vlera Totale (lekë)	Shënime
													Ndërtesë				
	Emër	Atësia	Mbiemër	Qyteti	Z.Kadastrale	Nr. i Pasurisë	Lloji i Pasurisë	Sip. Totale (m²)	Truall (m²)	Ndërtese(m²)	Vol	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (Leke/m²)	Vlera (lekë)		
1	Ylli Dhurata	Shuaip Avni	Shahini Shahini	Çorovodë	1420	13/100	Garazh	22	0	22	16	151	22		322,803	**322,803**	
2	Nasip	Skënder	Kono	Çorovodë	1420	13/86	Ndërtesë	30	0	30	11	138	30		571,152	**571,152**	
Vlera Totale																**893,955**	

VENDIM
Nr. 292, datë 24.4.2026

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "SISTEMIM, ASFALTIM, RRUGA 'PJETRUSHI', PRANË VARREZAVE TË QYTETIT, GRUDË E RE", BASHKIA SHKODËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Infrastrukturën dhe Energjinë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Sistemim, asfaltim, rruga 'Pjetrushi', pranë varrezave të qytetit, Grudë e Re", Bashkia Shkodër.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Shkodër.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit "arë", me një vlerë të përgjithshme prej 326 970 (treqind e njëzet e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 326 970 (treqind e njëzet e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë) lekësh përballohet nga buxheti i Bashkisë Shkodër.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Shkodër.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Shkodër

8. Bashkia Shkodër kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Shkodër.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Shkodër për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Shkodër për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Shkodër, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, PËR SHPRONËSIM, PËR INTERES PUBLIK, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "SISTEMIM ASFALTIM RRUGA 'PJETRUSHI', PRANË VARREZAVE TË QYTETIT, GRUDË E RE", BASHKIA SHKODËR

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)							VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM			VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME (kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)
											ARË				
	Emri	Atësia	Mbiemri	Numri i pasurisë	Zona kadastrale	Indeksi i hartës	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale (m^2)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)		
1	Dede		Shkambi	221/10	1965	178-A	ARE	5900	2	112	724	270	195,480	195,480	
2	Mhill	Gjon	Zefi	221/15	1965	178-A	ARE	4000	4	69	487	270	131,490	131,490	
Vlera totale														326,970	

VENDIM
Nr. 293, datë 24.4.2026

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "SISTEMIM-ASFALTIM I RRUGËVE 'XHEJMS BELUSHI', 'DHORI KOTI' DHE RRUGËVE LIDHËSE", BASHKIA KORÇË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Sistemim – asfaltim i rrugëve 'Xhejms Belushi', 'Dhori Koti' dhe rrugëve lidhëse", Bashkia Korçë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Korçë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit "arë", me një vlerë të përgjithshme prej 782 700 (shtatëqind e tetëdhjetë e dy mijë e shtatëqind) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 782 700 (shtatëqind e tetëdhjetë e dy mijë e shtatëqind) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Korçë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Korçë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Korçë.

8. Bashkia Korçë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Korçë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Korçë për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Korçë për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Korçë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "SISTEMIM – ASFALTIM I RRUGËVE 'XHEJMS BELUSHI', 'DHORI KOTI' DHE RRUGËVE LIDHËSE", BASHKIA KORÇË.

	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKARE								VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM									VLERA TOTALE (LEKË)	SHËNIME (kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)
												ARË			TRUALL			NDËRTESË				
Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Z. kada-strale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale (m²)	Arë (m²)	Truall (m²)	Ndërtesë (m²)	Sipërfaqja (m²)	Sip. (m²)	Çmimi (lekë/ m²)	Vlera (lekë)	Sip. (m²)	Çmimi (lekë/ m²)	Vlera (lekë)	Sip. (m²)	Çmimi (lekë/ m²)	Vlera (lekë)		
	A	B	C	Ç	D	E	F	G	H	I	L	N	M	O	P	Q	R	S	T	U	Z	Zh
1	Ervis	Vasil	Thanasi	2631	158/12	Arë	2,680	2,680				2,680	100	268000							268,000	
	Jorgo	Vasil	Thanasi																			
2	Petro	Lambi	Gorica	2631	158/20	Arë	3,150	3,150				3,150	100	315,000							315,000	
	Llambi	Andon	Gorica	2631																		
3	Skënder	Bektash	Armata	2631	158/94	Arë	2,175	2,175				124	100	12,400							12,400	
4	Anesti	Zeqir	Çoçka	2631	158/105	Arë	1,473	1,473				534	100	53,400							53,400	
5	Pandeli	Shefqet	Zotolli	2631	158/186	Arë	300	300				51	100	5,100							5,100	
	Sofia	Ramadan	Zotolli																			
6	Bujar	Shemsi	Shehu	2631	158/190	Arë	1,000	1,000				165	100	16,500							16,500	
7	Bujar	Shemsi	Shehu	2631	158/192	Arë	201	201				46	100	4,600							4,600	
8	Kristaq	Foto	Gusho	2631	158/245	Arë	1,463	1,463				575	100	57,500							57,500	
9	Kristaq	Foto	Gusho	2631	158/246	Arë	2,137	2,137				461	100	46,100							46,100	
10	Edmond	Skënder	Çalo	2631	158/207	Arë	825	825				41	100	4,100							4,100	
	Vlera totale e shpronësimit																				782,700	

VENDIM
Nr. 294, datë 24.4.2026

PËR MIRATIMIN E KOEFICIENTIT TË INDEKSIMIT TË BAZËS SË VLERËSUAR TË VITIT 2024, PËR LLOGARITJEN E PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të paragrafit të dytë, të nenit 10, dhe të pikave 1 e 3, të nenit 59, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit 2024, me koeficient indeksi 6.4 %, të llogaritur sipas kritereve të përcaktuara në nenin nr. 59, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

2. Indeksi i përcaktuar sipas pikës 1, të këtij vendimi, aplikohet për llogaritjen e bazës së vlerësuar individuale vjetore, të arritur nëpërmjet kontributeve të paguara dhe rivlerësimeve të tyre, të kryera deri në vitin 2024, dhe zbatohet për efekt të llogaritjes së masës fillestare mujore të pensioneve, me datë lindjeje të së drejtës, nga data 1.1.2026 e në vazhdim.

3. Indekset akumulative të bazës së vlerësuar, të arritura nëpërmjet pagave të periudhës 1994–2024, referuar kontributeve të paguara, sipas muajve në këtë periudhë dhe pagave referuese, sipas punëve dhe profesioneve, të përcaktuara me vendimin nr. 561, datë 12.8.2005, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e pagave referuese për llogaritjen e pensioneve", të ndryshuar, sipas viteve, janë sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Pas aplikimit të indeksit të vitit 2024, baza e vlerësuar për efekt të llogaritjes së masës fillestare mujore të pensioneve, që do të caktohen me datë lindjeje të së drejtës, nga data 1.1.2026, nuk mund të jetë më e lartë, se:

a) trefishi i pagës minimale në shkallë vendi, e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, për pagat e periudhës, nga viti 1994 deri në 31.12.2001;

b) paga maksimale në shkallë vendi, e përcaktuar sipas kritereve të nenit 10, të ligjit nr. 7703, datë 1.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për pagat e periudhës, nga viti 2002 e në vazhdim.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, lidhen me zbatimin e formulës së caktimit të pensioneve dhe aplikohen vetëm për pensionet që caktohen me datë lindjeje të së drejtës, nga data 1.1.2026 e në vazhdim, dhe përballohen brenda buxhetit vjetor, të miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

6. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2026.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1

Tabela e koeficientëve akumulativë të indeksimit të bazës së vlerësuar	
Për pagat referuese deri në datën 31.12.1993	14.259
Për pagat e vitit 1994	14.259
Për pagat e vitit 1995	11.474
Për pagat e vitit 1996	8.903
Për pagat e vitit 1997	8.903
Për pagat e vitit 1998	7.440
Për pagat e vitit 1999	6.038
Për pagat e vitit 2000	5.499
Për pagat e vitit 2001	4.704
Për pagat e vitit 2002	4.345
Për pagat e vitit 2003	3.889
Për pagat e vitit 2004	3.532
Për pagat e vitit 2005	3.208
Për pagat e vitit 2006	2.913

Për pagat e vitit 2007	2.784
Për pagat e vitit 2008	2.459
Për pagat e vitit 2009	2.262
Për pagat e vitit 2010	2.165
Për pagat e vitit 2011	2.084
Për pagat e vitit 2012	2.004
Për pagat e vitit 2013	1.921
Për pagat e vitit 2014	1.921
Për pagat e vitit 2015	1.660
Për pagat e vitit 2016	1.660
Për pagat e vitit 2017	1.627
Për pagat e vitit 2018	1.571
Për pagat e vitit 2019	1.534
Për pagat e vitit 2020	1.490
Për pagat e vitit 2021	1.438
Për pagat e vitit 2022	1.321
Për pagat e vitit 2023	1.163
Për pagat e vitit 2024	1.064
Për pagat e vitit 2025	1.000
Për pagat e vitit 2026	1.000

VENDIM
Nr. 295, datë 24.4.2026

PËR DISA shtesA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN Nr. 769, datë 13.12.2024, tË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR TRANSFERIMIN TE KORPORATA E INVESTIMEVE SHQIPTARE TË PRONAVE SHTETËRORE PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT TË INVESTIMIT 'RIJETËZIMI I STADIUMIT 'SELMAN STËRMASI', TIRANË'"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 71/2019, "Për Korporatën e Investimeve Shqiptare", dhe në zbatim të shkronjës "b", të pikës 1, të kreut II, të vendimit nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfiteozë, *leasing*, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 769, datë 13.12.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për transferimin te Korporata e Investimeve Shqiptare të pronave shtetërore për realizimin e projektit të investimit 'Rijetëzimi i stadiumit 'Selman Stërmasi', Tiranë"', bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 2 bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

i. Pas fjalëve "... për të vepruar si zhvillues ..." shtohen "... nëpërmjet instrumentit ligjor të sipërmarrjes ...";

ii. Fjalët "... vendimeve nr. 95, datë 9.9.2024 dhe nr. 112, datë 8.10.2024 ..." zëvendësohen me "... vendimeve nr. 95, datë 9.9.2024, nr. 112, datë 8.10.2024 dhe nr. 36, datë 30.3.2026 ...".

b) Në fund të pikës 7 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

"Ngarkohet Korporata të kryejë procesin e konsolidimit të pronave, të përcaktuara në shtojcat nr. 1 dhe nr. 2, në rast se konstatohet mospërputhje midis gjendjes faktike dhe ligjore të pronës.".

c) Në shtojcën nr. 2, bashkëlidhur vendimit, bëhen shtesat e mëposhtme:

i. Në titull, pas fjalës "... publik ..." shtohen fjalët "... dhe privat ...";

ii. Shtohen pronat, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Bashkia Tiranë dhe Korporata e Investimeve Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e pasurisë (m²)	Nga sip.		Institucioni me pronësi/ përgjegjësi administrimi
			Truall (m²)	Ndërtesë (m²)	
8270	1/301	90	90	0	shtet
8270	1/302	54	-	-	shtet
8270	1/303	93	-	-	shtet
8270	1/304	87	-	-	shtet

VENDIM
Nr. 297, datë 24.4.2026

PËR SHPALLJEN E DISA ZONAVE ME PËRPARËSI ZHVILLIMIN E EKONOMISË MALORE NË BASHKINË SELENICË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 20/2025, "Për paketën e maleve", me propozimin e ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Këshilli i Ministrave

VENDOSI**:**

1. Shpalljen "Zonë me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore" të disa zonave në territorin e Bashkisë Selenicë, si më poshtë vijon:

a) Zona nr. 1, fshati Mesaplik, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 14.08 (katërmbëdhjetë pikë zero tetë) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

b) Zona nr. 2, fshati Bashaj, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 1.96 (një pikë nëntëdhjetë e gjashtë) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

c) Zona nr. 3, fshati Vërmik, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 271.87 (dyqind e shtatëdhjetë e një pikë tetëdhjetë e shtatë) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

ç) Zona nr. 4, fshati Brataj, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 8.54 (tetë pikë pesëdhjetë e katër) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

d) Zona nr. 5, fshati Gjorm, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 778.90 (shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë pikë nëntëdhjetë) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

dh) Zona nr. 6, fshati Lepenicë, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 10.20 (dhjetë pikë njëzet) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

e) Zona nr. 7, fshati Gjorm, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 3.96 (tre pikë nëntëdhjetë e gjashtë) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

ë) Zona nr. 8, fshati Malas, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 24.01 (njëzet e katër pikë zero një) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

f) Zona nr. 9, fshati Brataj, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 4.04 (katër pikë zero katër) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

g) Zona nr. 10, fshati Brataj, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 12.16 (dymbëdhjetë pikë gjashtëmbëdhjetë) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

gj) Zona nr. 11, fshati Mesaplik, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 3.48 (tre pikë dyzet e tetë) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

h) Zona nr. 12, fshati Bashaj, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 1.14 (një pikë katërmbëdhjetë) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

i) Zona nr. 13, fshati Velçë, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 43.24 (dyzet e tre pikë njëzet e katër) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

j) Zona nr. 14, fshati Mesaplik, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 25.42 (njëzet e pesë pikë dyzet e dy) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

k) Zona nr. 15, fshati Ramicë, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 12.48 (dymbëdhjetë pikë dyzet e tetë) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

l) Zona nr. 16, fshati Brataj, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku

Vlorë, me sipërfaqe 1.75 (një pikë shtatëdhjetë e pesë) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

ll) Zona nr. 17, fshati Lepenicë, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 19.22 (nëntëmbëdhjetë pikë njëzet e dy) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

m) Zona nr. 18, fshati Brataj, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 1.04 (një pikë zero katër) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

n) Zona nr. 19, fshati Mesaplik, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 102.36 (njëqind e dy pikë tridhjetë e gjashtë) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

nj) Zona nr. 20, fshati Mesaplik, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 9.82 (nëntë pikë tetëdhjetë e dy) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

o) Zona nr. 21, fshati Bashaj, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 0.71 (zero pikë shtatëdhjetë e një) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

p) Zona nr. 22, fshati Matogjin, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 1.18 (një pikë tetëmbëdhjetë) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

q) Zona nr. 23, fshati Brataj, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 28.04 (njëzet e tetë pikë zero katër) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

r) Zona nr. 24, fshati Bashaj, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 2.69 (dy pikë gjashtëdhjetë e nëntë) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

rr) Zona nr. 25, fshati Gjorm, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 14.33 (katërmbëdhjetë pikë tridhjetë e tre) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

s) Zona nr. 26, fshati Mesaplik, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 1.37 (një pikë tridhjetë e shtatë) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

sh) Zona nr. 27, fshati Brataj, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 282.18 (dyqind e tetëdhjetë e dy pikë tetëmbëdhjetë) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

t) Zona nr. 28, fshati Lepenicë, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 11.43 (njëmbëdhjetë pikë dyzet e tre) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

th) Zona nr. 29, fshati Brataj, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 2.69 (dy pikë gjashtëdhjetë e nëntë) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

u) Zona nr. 30, fshati Bashaj, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 89.84 (tetëdhjetë e nëntë pikë tetëdhjetë e katër) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

v) Zona nr. 31, fshati Gjorm, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 4.63 (katër pikë gjashtëdhjetë e tre) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

x) Zona nr. 32, fshati Brataj, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 1.97 (një pikë nëntëdhjetë e shtatë) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

xh) Zona nr. 33, fshati Velçë, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 71.72 (shtatëdhjetë e një pikë shtatëdhjetë e dy) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

y) Zona nr. 34, fshati Brataj, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 1.78 (një pikë shtatëdhjetë e tetë) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

z) Zona nr. 35, fshati Brataj, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 44.96 (dyzet e katër pikë nëntëdhjetë e gjashtë) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

zh) Zona nr. 36, fshati Mesaplik, pjesë e Njësisë Administrative Brataj, Bashkia Selenicë, qarku Vlorë, me sipërfaqe 12.99 (dymbëdhjetë pikë nëntëdhjetë e nëntë) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH.

2. Shtrirja, kufijtë dhe pikat e hyrjes e të daljes së këtyre zonave përcaktohen në hartën treguese, sipas sistemit KRGJSH, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Llojet e aktiviteteve, që do të zhvillohen në këtë zonë, janë:

a) të zhvillimit ekonomik;

b) të zhvillimit industrial;

c) të zhvillimit turistik.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Selenicë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



Zona 1 Njësia Administrative Brataj					
Nr.	**Koordinata X**	**Koordinata Y**	**Nr.**	**Koordinata X**	**Koordinata Y**
1	473982.1481	4459794.07	**30**	473974.6075	4460231.639
2	473923.8074	4459792.086	**31**	474000.4044	4460264.58
3	473896.7819	4459818.721	**32**	474054.7764	4460288.392
4	473930.3029	4459843.15	**33**	474065.4921	4460293.552
5	473952.1046	4459825.37	**34**	474081.764	4460307.442
6	473988.47	4459821.343	**35**	474114.7047	4460314.983
7	474003.6075	4459823.081	**36**	474122.2453	4460303.473
8	474003.9631	4459835.954	**37**	474138.1203	4460291.17
9	474010.3131	4459842.727	**38**	474152.4079	4460281.248
10	474012.0064	4459873.207	**39**	474157.5672	4460273.311
11	473999.7297	4459892.469	**40**	474161.9329	4460256.245
12	473972.848	4459923.372	**41**	474169.0766	4460245.926
13	473967.9797	4459922.314	**42**	474180.9829	4460233.226
14	473956.7613	4459920.832	**43**	474204.0017	4460229.258
15	473946.3896	4459911.096	**44**	474262.3425	4460121.704
16	473945.1196	4459890.352	**45**	474232.9736	4460088.764
17	473936.8646	4459885.907	**46**	474202.4142	4460090.351
18	473929.2446	4459847.384	**47**	474198.0486	4459957.795
19	473894.1079	4459823.139	**48**	474188.9204	4459935.966
20	473863.4161	4459889.849	**49**	474171.061	4459896.676
21	473808.9119	4460006.531	**50**	474152.8047	4459854.607
22	473789.6634	4460049.87	**51**	474110.7359	4459833.572
23	473826.5728	4460078.048	**52**	474081.3671	4459854.607
24	473847.2104	4460092.336	**53**	474060.7296	4459852.623
25	473886.1042	4460107.417	**54**	474045.2514	4459833.572
26	473924.998	4460160.598	**55**	474008.4742	4459823.415
27	473940.4762	4460178.854	**56**	474000.32	4459817.626
28	473950.795	4460187.189	**57**	473982.1481	4459794.07
29	473961.1137	4460209.414			



Zona 2 Njësia Administrative Brataj		
Nr.	**Koordinata X**	**Koordinata Y**
1	478987.8662	4464076.631
2	478970.321	4464079.043
3	478932.5543	4464082.657
4	478898.1055	4464102.66
5	478883.6592	4464124.885
6	478883.183	4464153.142
7	478894.613	4464186.321
8	478893.978	4464227.755
9	478911.4405	4464252.679
10	478941.9206	4464255.377
11	478980.6557	4464254.901
12	479012.882	4464225.215
13	479024.312	4464207.276
14	479020.8195	4464183.622
15	479017.6445	4464166.953
16	479000.6582	4464122.027
17	478989.4674	4464082.314
18	478987.8662	4464076.631


ZONA ME PËRPARËSI ZHVILLIMIN E EKONOMISË MALORE
ZONA 3, NJËSIA ADMINISTRATIVE BRATAJ, BASHKIA SELENICË, QARKU VLORË
AKPT
AMVV
Njësia Administrative
Zona
Sipërfaqja (ha)
Brataj
Zona 1
14.08
Brataj
Zona 2
1.96
Brataj
Zona 3
271.87
Brataj
Zona 4
8.54
Brataj
Zona 5
778.50
Brataj
Zona 6
10.20
Brataj
Zona 7
3.96
Brataj
Zona 8
24.01
Brataj
Zona 9
4.04
Brataj
Zona 10
12.16
Brataj
Zona 11
3.48
Brataj
Zona 12
1.14
Brataj
Zona 13
43.24
Brataj
Zona 14
25.42
Brataj
Zona 15
12.48
Brataj
Zona 16
1.75
Brataj
Zona 17
19.23
Brataj
Zona 18
1.04
Brataj
Zona 19
102.36
Brataj
Zona 20
9.82
Brataj
Zona 21
0.71
Brataj
Zona 22
1.18
Brataj
Zona 23
28.04
Brataj
Zona 24
2.60
Brataj
Zona 25
14.33
Brataj
Zona 26
1.37
Brataj
Zona 27
282.18
Brataj
Zona 28
11.43
Brataj
Zona 29
2.60
Brataj
Zona 30
85.84
Brataj
Zona 31
4.63
Brataj
Zona 32
1.57
Brataj
Zona 33
71.72
Brataj
Zona 34
1.78
Brataj
Zona 35
44.96
Brataj
Zona 36
12.59
1:10,000
Km
Legjendë
Zona me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore
Ndërtesa
Bashkia Selenicë
Izolimi
Kategoritë e Rrjetit Rrugor
F. Rrugë Lokale
*Zona 3 ndodhet në territorin e Njësisë Administrative Brataj me sipërfaqe prej 271.87 ha.
**Sistemi Koordinativ: KRGJSH i Komisë Referuese Gjeodezike Shqiptare/ ETRS 89
Zona 3
Manastir (Vërmiko)
Map data © OpenStreetMap contributors, Microsoft, Facebook, Google, Esri Community Maps contributors, Map layer by Esri
479000
480000
481000
4465000
4454000

Zona 3 Njësia Administrative Brataj					
Nr.	**Koordinata X**	**Koordinata Y**	**Nr.**	**Koordinata X**	**Koordinata Y**
1	479800.6745	4464327.356	**46**	480867.4028	4463639.391
2	479615.4658	4464251.288	**47**	480856.2902	4463621.928
3	479468.6218	4464386.226	**48**	480822.9527	4463610.816
4	479356.1737	4464537.7	**49**	480810.2526	4463591.766
